



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2022:106253
Datë: 16.12.2024
Numri i dokumentit: 06601874

K.DH.SH.II.nr.143/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A, me NUI: 810514829, me seli në rr. “28 Nëntori”, nr. 181, Lagjja Dardania, në Prishtinë, kundër debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., me NUI: 811285205, me seli në rr. “28 Nëntori”, nr. 4, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1524/23 të datës 27.10.2023, me datë 16.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar ankesa e kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A, me NUI: 810514829, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1524/23 të datës 27.10.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

1. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., me NUI: 811285205, me seli në Prishtinë, ashtu që ANULOHET pjesërisht urdhri përmbartimor P.nr.176/2022 dt.29.04.2022 i Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, për shumën e detyrimit prej 3,842.58 Euro dhe për këtë pjesë të detyrimit përfundon procedura përmbartimore.

2. REFUZHOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., me NUI: 811285205, me seli në Prishtinë, për pjesën tjetër të detyrimit në shumën prej 3,247.63 Euro dhe për këtë pjesë të detyrimit MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.176/2022 dt.29.04.2022 i Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1524/23 të datës 27.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.176/22 të datës 29.04.2022, të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha dhe e ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori “Termokos” Sh.A me seli në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të anulohet si i pabazuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.176/22 të datës 29.04.2022 , me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës së kontabilitetit Nr. 06075 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga kartela e kontabilitetit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 7,090.21 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimi, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1524/23 të datës 27.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.176/22 të datës 29.04.2022, të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha dhe e ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore. Në arsyet e aktvendimit të atakuar ka theksuar se Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Kartela e kontabilitetit me numër 06075, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, andaj Dhomat e Shkallës së Dytë nuk mund ta pranoj përfundimin dhe

qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me aktvendimin e atakuar nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk ka vlerësuar drejtë dokumentin e besueshëm nisur nga fakti se kreditori është ndërmarrje publike komunale për ofrimin e shërbimeve të ngrohjes, nga e cila debitori përfiton shërbimet komunale të ofruara. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se kartela e klientit – debitorit përmban të dhënat e mjaftueshme të cilat duhet t'i përmbajë ekstrakti afarist. Kartela financiare e ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime komunale, lëshohet për konsumatorët që shfrytëzojnë shërbimet e tilla dhe faturimi ka të bëjë po me këtë shërbim. Është i padrejtë trajtimi që gjykata e shkallës së parë i jep dokumentit të besueshëm për mungesë të faktit se ngrohja nuk theksohet si mundësi ligjore në Nenin 29 par.1 të LPP-së, përderisa këto shërbime i pranon debitori dhe nuk ka kontestuar shërbimin e pranuar. Në një gjendje të tillë të çështjes, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për të qenë i përmbareshëm, andaj vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP-së për të pranuar përmbarimin.

Duke shqyrtuar dokumentin e besueshëm, kjo Gjykatë vlerëson se nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit ndaj debitorit për shumën prej 7,090.21, euro, dhe periudha kohore për të cilën ka të bëjë shumën e detyrimit sipas këtij ekstrakti është prej 30.11.2015 deri me 31.12.2021.

Duke i vlerësuar provat që gjenden në shkresat e lëndës, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë ndryshe gjendjen faktike në raport me të gjykuarit në shkallë të parë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate nga ekstrakti – kartela financiare evidentohet se debitori përmes kartelës financiare kërkon detyrimin për periudhën 30.11.2015 deri me 31.12.2021 në shumën prej 7,090.21 euro. Nga vlerësimi i ekstraktit si dokument i besueshëm, vërtetohet se debitori ka bërë disa pagesa nga detyrimi i tij në shumën e ndryshme duke vazhduar kohë pas kohe me pagesa jo të rregullta. Bazuar nga evidencat e pagesave si dhe faktin se debitori është thirrë në parashkrim të kërkesës, kjo Gjykatë ka vlerësuar vet provat – pretendimet e debitorit dhe ka ardhur në përfundim se janë pjesërisht të bazuara pretendimet për parashkrim të kërkesës.

Në rastin konkret, kjo Gjykatë vlerëson se pjesa e detyrimit ta debitorit ndaj kreditorit dhe atë në shumën prej 3,842.58 Euro (për periudhën deri me datë 31.03.2019 ka arritur afatin e parashkrimit, për faktin se nga ekstrakti si dokument i besueshëm, pjesa e detyrimit nga koha kur fillon detyrimi deri në periudhën tri vite nga përfundimi i ekstraktit, rezulton se borxhi është parashkuar.

Ne lidhje me këtë çështje kjo gjykatë vlerëson se me Nenin 341 par.1 të LMD (2012) parashihet se *“Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit”*, ndërsa me paragrafin 2 po të njëjtit ligj përcaktohet se: 2. *Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me*

ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Me Nenin 355 të LMD parashihet se “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite.”.

Ne rastin konkret, kjo gjykatë bazuar në datën kur është parashtruar propozimi për përmbarim (me datë 28.04.2022) ka shqyrtuar afatin e parashkrimit nga periudha e përfundimit të ekstraktit (dt.31.12.2022) në afat paraprak tre vjeçar për shërbimet komunale për subjekte juridike bazuar në Nenin 355 të LMD. Në këtë kuptim, Gjykatës i rezulton se borxhi nga data e fundit në ekstrakt 30.12.2022 në periudhën paraprake tri vjeçare gjer më 30.04.2019 rezulton të mos jetë parashkruar. Kjo shumë sipas ekstraktit evidentohet në vlerë 13247,63 euro, të cilën gjykata vendosi të lë në fuqi urdhrin për përmbarim. Ndërkaq për periudhën nga data 31.03.2019 e gjer me datë 29.11.2015 gjykatës i rezulton se kërkesa është parashkruar dhe atë në shumën prej 3,842.58 euro.

Prandaj, Gjykata e Shkallës së Dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me gjendjen faktike të vërtetuar nga e njëjta. Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoi ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjeti se prapësimi i debitorit duhet të aprovohet pjesërisht vetëm për shumën e detyrimit të parashkruar në vlerë prej 3,842.58 Euro, për të cilën është anuluar urdhri për përmbarim, ndërkaq për shumën e detyrimit prej 3,247,63 euro për periudhën nga data prapësimi i debitorit duhet të refuzohet si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, u vendos konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së duke vendosur që debitori t’i bartë shpenzimet e procedurës si palë gjyq humbëse.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.143/24, me datë 16.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova